



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauke i Tehnologije*  
*- Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Datë/a:	18.01.2018
Referenc-ë:	436-013
Për/ Za/ To:	Drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA)
Përmes/Preko/Through:	u.d. Sekteratarit të Përgjithshëm z. Alush Istogu
Nga/ Od/ From:	Shyqiri Bytyqi - Ministër i MASHT
Tema/ Subjekat/Subject:	Rekomandim për bashkëpunim dhe përkrahje të garës ndërkombëtare të matematikës "Kangaroo" në Kosovë

Të nderuar Drejtorë të DKA-ve,

Përmes kësaj shkrese ju informojmë që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e përkrahë garën ndërkombëtare të matematikës "Kangaroo" që merret me identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me talente në fushën e matematikës, e cila organizohet në Kosovë nga Instituti ATOMI dhe ka për qëllim promovimin e matematikës në vendin tonë. Gara "Kangaroo" organizohet nën ombrellën e "Asociacionit Kangourou Sans Frontières (AKSF)" në të njëjtën ditë në mbarë botën dhe në të marrin pjesë për çdo vit mbi 6 milionë nxënës të arsimit parauniversitar nga mbi 70 shtete të ndryshme të botës. Kosova përmes Institutit ATOMI është bërë anëtare e AKSF-së dhe për herë të parë, duke filluar nga viti 2017, Instituti ATOMI e organizon garën "Kangaroo" në Kosovë në përputhje me rregullat, procedurat dhe standardet e përcaktuara nga AKSF.

Andaj i inkurajojmë të gjitha DKA-të që t'i ofrojnë Institutit ATOMI përkrahje dhe bashkëpunim të plotë për organizimin e garës "Kangaroo". Gjithashtu, i lusim Drejtorët e DKA-ve që t'i inkurajojnë drejtorët dhe mësimmshënësit e IEAA-ve që të bashkëpunojnë me personelin e Institutit ATOMI në funksion të organizimit sa më të mirë të kësaj gare në Kosovë.

Shpresojmë në mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe përkrahjen tuaj për Institutin ATOMI!

Me respekt,  
Shyqiri Bytyqi  
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë